

Bashkim Selmani, PhD¹

UDC:
340.114-042.3(4:37)

**NDIKIMI I TË DREJTËS ROMAKE NË SISTEMIN MODERN
EVROPIAN TË DREJTËSISË**

**ВЛИАНИЕТО НА РИМСКОТО ПРАВО ВРЗ МОДЕРНИОТ
ЕВРОПСКИ СИСТЕМ НА ПРАВДАТА**

**THE IMPACT OF ROMAN LAW IN THE MODERN EUROPEAN
JUSTICE SYSTEM**

Abstract

The diversity of rights in the history of states and justice has had a different historical impact, because even today, states cannot yet fully unify the right that is applied in their and international territory. Especially today, in Europe states tend to align their rights without wanting to unite them in a single right. This and many other dilemmas remain to be explored. But, even our own theme that we are discussing requires to elaborate in the possible way to be understood what role it had and has today the Roman law, its influence on modern justice and exactly which branch of Roman law is inherited through the largest foreign legal systems of law. The variety of rights has been as great as that of languages, cultures and societies. In the modern world, based on sovereignty of states, there are at least as many justice systems as there are states, even more so while some states have not completely unified the right that is applied in their territory. The scientific study of Roman law and the comparison of rights permit a classification of rights, which gives a general picture of all the rights that are applied today in the world and thus allows that the studied foreign law in particular to be

¹ Professor of Law at the Faculty of Law in the University of Tetovo - Tetovo, in the course Roman law – Ius romanus.

placed in an assigned place. Roman law is one of the traditional introductory disciplines in law faculties in Europe, and aims to provide students with the necessary knowledge of the common legal systems of continental Europe. Since its practical implementation has been completed, it has the character of the juridical-historical discipline with an approximately unified content in most of the law faculties of European universities.

Keywords: Roman law, diversity of rights, history of states, unification, implementation, and states, national, international, war, causes of war, victory, European law, family law, inheritance, pater family.

1. Shumëllojshmëria e të drejtave nëpër historinë e shteteve

Shumëllojshmëria e të drejtave nëpër historinë e shteteve dhe së drejtës ka pasur një ndikim të ndryshim historik, sepse edhe sot, e kësaj dite shtetet, akoma nuk mund të arrijnë të unifikojnë krejtësisht të drejtën që zbatohet në territorin e tyre por, edhe atë ndërkombëtar. Veçanërisht sot, në Evropë shtetet kanë tendencë t’i për afrojnë të drejtat e tyre pa dashur t’i bashkojnë ato në një të drejtë të vetme. Kjo dhe shumë dilema të tjera ngelen për t’u hulumtuar. Por, pikërisht edhe tema e jonë që e kemi për diskutim kërkon që të shtjellojmë në mënyrën e mundshme për t’u kuptuar se çfarë roli ka pasur dhe ka edhe sot e kësaj dite e drejta romake, ndikimi i saj në të drejtën moderne dhe pikërisht në cilën degë të së drejtës romake është e trashëguar nëpër sistemet ligjore më të mëdha të huaja të së drejtës. Shumëllojshmëria e të drejtave ka qenë po aq e madhe sa dhe ajo e gjuhëve, kulturave dhe shoqërive. Në botën moderne, të bazuar mbi sovranitetin e shteteve, ka të paktën po aq sisteme të së drejtës sa ka edhe shtete, madje edhe më shumë përderisa disa shtete nuk e kanë unifikuar krejtësisht të drejtën që zbatohet në territorin e tyre si për shembull e drejta skoceze në Mbretërinë e Bashkuar, i Luizianës në SHBA, etj. Studimi shkencor i së drejtës romake dhe krahasimi i të drejtave lejon një klasifikim të të drejtave, i cili jep një pamje të përgjithshme të të gjitha të drejtave që zbatohen sot në botë dhe në këtë mënyrë lejon që e drejta e huaj e studiuar në veçanti të vendoset në një vend të caktuar.²

² Bashkim Dr. Selmani & Bekim Rexhepi “E drejta romake - ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore”, f. 656-661. Ferizaj, 2014

2. Ndikimi i së drejtës romake në botën moderne të të drejtës

Kuptimi i sistemeve bashkëkohore dhe drejtësia romake- Ndikimi i së drejtës romake në botën moderne ka qenë i jashtëzakonshëm, ajo përbën bazën historike dhe konceptuale të shumë sistemeve ligjore në mbarë botën. Impakti i saj nuk është kufizuar vetëm në ato shtete të Evropës Perëndimore që bënin pjesë në Perandorinë Romake. Kudo ku evropianët krijuan vendbanime, morën me vete të drejtën e tyre zakonisht e bazuar deri diku në parimet e së drejtës romake. Disa shtete, megjithëse nuk e përjetuan vendosjen e evropianëve, adoptuan kode ligjore të cilat bazoheshin në masë të madhe në parimet e së drejtës romake. Megjithatë, edhe shtetet që kishin si burim common law-in anglez, nuk mbetën të paprekura nga ndikimi i së drejtës romake. Ndarja administrative e Perandorisë Romake filloi gjatë mbretërisë së Diokletianit u zyrtarizua në vitin 395. Gjatë shekujve katër dhe pesë, u shfaqën dy perandori të ndryshme dhe, me kalimin e kohës, u bë ndarja në çështje administrative dhe teologjike. Me rënien e Perandorisë së Perëndimit në vitin 476, qendra e pushtetit që kishte pushuar prej kohësh se qeni në Romë, u vendos në Kostandinopojë më vonë u quajt Bizant, mbi Bosfor, i cili, që nga ajo kohë, ka qenë kryeqyteti i Perandorisë së Lindjes. Megjithëse banorët e kësaj perandorie vazhduan ta konsideronin veten romakë, lingua franca ishte greqishtja dhe ndikimet e forta kulturore nga Greqia dhe Lindja e Afërt gradualisht e transformuan atë në Perandorinë Bizantine.

3. Krahasimi i të drejtave dhe rëndësia e së drejtës romake si element thelbësor

Duke konsideruar rëndësinë e ligjit si element thelbësor i një komuniteti të kultivuar, kontributi i së drejtës romake në qytetërimin modern është i gjithanshëm. Ndikimi i saj nuk është ndier vetëm në koncepte, rregulla të mirëfillta dhe doktrina ligjore, por edhe në procedurat e teknikat civile, veçanërisht në klasifikimin e ligjit dhe në analizën e shkencës së kauzave. Avokati i cili zotëron bazat e së drejtës romake, ka pasaportën për të kuptuar ligjin dhe sistemet ligjore të shumë shteteve. E drejta romake e ka përmbushur dy herë në të shkuarën funksionin e një *ius commune* të drejtën komune të një pjese të madhe të botës. Hera e parë ishte në kulmin e Perandorisë Romake kur e gjithë bota ishte Roma dhe e drejta romake, përdorej të paktën në teori, në të

gjitha provincat e Perandorisë deri në pjesën më të madhe të Evropës Perëndimore dhe Afrikës Veriore.³

Megjithëse kjo Perandori ishte e destinuar të shpërbëhej me kalimin e kohës, e drejta romake do të tregonte se ishte një nga testamentet e saj më jetëgjata. Jeta e dytë e së drejtës romake si *ius commune* filloi në fundin e shekullit të njëmbëdhjetë.⁴ Me rizbulimin shkencor të së drejtës romake në Itali, transformimin dhe përshtatjen nga juristë italianë dhe francezë gjatë dy shekujve pasardhës, e drejta Mesjetare kombini i së drejtës Romake dhe së drejtës kanonike, përzier me të drejtën zakonore, nisi të bëhej *ius commune* i Evropës së mesjetës së vonë. Kjo nuk do të thotë se ekzistonte një trup homogjen ligjor i përhapur në Evropën Perëndimore gjatë kësaj periudhe. Asgjë nuk mund të ishte më larg së vërtetës. Termi evropian *ius commune* në sensin e tij historik, do të thotë që, duke filluar nga shekulli i katërbëdhjetë deri në fillimin e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, pjesa më e madhe e Evropës kishte të njëjtën traditë ligjore. Ekzistonin shumë variacione lokale dhe rajonale të ligjit, por, terminologjia, konceptet dhe struktura e dhënë nga elementet e së drejtës Romake, përcaktonte një kuadër të përbashkët. Një numër i madh shembujsh të përdorimit të vazhdueshëm dhe të ndikimit të parimeve të së drejtës Romake në sistemet ligjore, janë përmendur tashmë.⁵ Qëllimi i këtij kapitulli të fundit është të tregojë se si kodifikimi i Justinianit arriti të ndikonte botën moderne.

4. Pranimi i së drejtës romake ne Evropën Perëndimore

Pranimi i së drejtës romake ne Evropën Perëndimore, mund të ndahet në tri faza të cilat lidhen me njëra-tjetrën deri në ngritjen e disa rrymave të caktuara ligjore-filozofike. Faza e parë, nga rizbulimi shkencor i së drejtës Romake në Itali në fund të shekullit të njëmbëdhjetë deri në fillim të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, shihet përgjithësisht si periudha formuese e *ius commune* evropiane. Ishte gjatë kësaj periudhe që parimet, terminologjia dhe struktura e së drejtës Romake, u plazmuan në një të drejtë të kultivuar mesjetare për t'u bërë më pas shtylla e një

³ Bashkim Dr. Selmani & Bekim Rexhepi “E drejta romake - ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore”, f. 656-661. Ferizaj, 2014

⁴ Referohu, Zimmermann, R., “Savignys legacy: Legal History, Comparative Law and the Emergence of a European Legal Science” (1996) 45 ICLQ, 576-605;

⁵ Referohu Coing, H., “The Roman Law as *ius Commune* on the Continent”, (1973) 89 LQR, 505-17.

kulture të përbashkët ligjore evropiane, në të cilën e drejta ekzistuese e zakonshme mund të zhvillohej në sisteme kombëtare ligjore. Sidoqoftë, nuk duhet harruar se: “Ajo që u vol nuk ishte e drejta klasike romake në formën e saj fillestare, e cila ishte krejtësisht e panjohur në atë kohë, ashtu si edhe ligji i Justinianit. Më shumë ishte *ius commune* i Europës, i prodhuar nga Corpus Iuris i Justinianit nga Glosatorët dhe, në një shkallë të gjerë, nga komentuesit të cilët bashkuan statutet e zakonet, si dhe nga praktikantët tregtarë aktualë e sidomos ato të Italisë Veriore.”⁶

Faza e dytë e pranimit, nga fillimi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë deri në gjysmën e shekullit të tetëmbëdhjetë, lidhet me rritjen e kombitshitet dhe zhvillimin e sistemeve ligjore kombëtare të bazuara në parimet e *ius commune* evropiane. Ndikimi i parimeve të së drejtës romake mbi zhvillimin ligjor gjatë kësaj periudhe ishte disi i ndryshëm. Siç ka vënë re Stein-i.⁷ Në fund të shekullit të pesëmbëdhjetë *ius commune*, që u zhvillua nga Bartolistët, po bëhej gjithnjë e më shumë ndikues në mbarë Evropën, pasi u themeluan universitete të reja dhe më shumë juristë po trajnoheshin në studimin tradicional. Megjithatë, në të njëjtën kohë, sa më shumë përshtatej për të gjetur zgjidhje ndaj problemeve bashkëkohore, aq më shume *ius commune* largohej nga ligji i Justinianit nga i cili buronte autoriteti i saj. Ishte gjithashtu gjatë kësaj faze të dytë të pranimit që zbatimi universal i së drejtës Romake, si baza e *ius commune* evropiane, filloi të trajtohej si çështje, fillimisht nga juristët, humanistët e shekullit të gjashtëmbëdhjetë dhe më pas nga mbështetësit e doktrinës laike të ligjit natyror, gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë.⁸

Faza e tretë dhe përfundimtare e pranimit, nga gjysma e shekullit të tetëmbëdhjetë deri në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, përjetoj lindjen e kodifikimeve të ndryshme kombëtare të së drejtës në Evropën Perëndimore. Siç do të tregohet dhe më poshtë, parimet dhe struktura e së drejtës Romake përmbushi gjithashtu edhe një funksion të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe. Adoptimi i kodeve franceze, gjermane dhe zvicerane nga shtete të tjera gjithashtu rezultoi në një Pranim të mëvonshëm të së drejtës Romake jashtë Evropës Perëndimore.⁹

⁶ (Wieacker, History, 98).

⁷ (Roman Laiu, 75):

⁸ Legrand P., “European Legal Systems are not Converging” (1996) 45 ICLQ, 52-81.

⁹ Referohu, Zimmermann, R., “Savignys legacy: Legal History, Comparative Law and the Emergence of a European Legal Science” (1996) 45 ICLQ, 576-605;

Shtetet e Bashkuara përgjithësisht konsiderohen si sisteme ligjore zakonore, por për gjysmë shekulli pas pavarësisë ekzistonte një perspektivë reale se e drejta civile do të rezultonte supreme dhe ashtu ndodhi në Luiziana, gjë që shpalli një kod ndikues Romak, në vitin 1825, të bazuar në të drejtën Franceze dhe atë Romake. Disa prej burrave të shquar të shtetit të kësaj periudhe, si Xhon Adams dhe Tomas Xheferson, ishin jo vetëm admirues të mëdhenj të Romës antike, por dhe eruditë në të drejtën e saj. Nuk ishte çudi që pas Revolucionit filloi të lindte një armiqësi kundrejt common law-it dhe një pranim ndaj ndikimeve franceze. E drejta civile dhe natyrore ishin elemente të rëndësishme të arsimit ligjor, juristët amerikanë lexonin Pothier dhe tekstet ligjore të periudhës ishin tej mase entuziaste për të drejtën civile. Megjithatë, profesioni ligjor nuk e kishte këtë entuziazëm dhe ky ishte ndoshta faktori më i madh që shpjegoi arsyen pse e drejta Romake, që konsiderohej si një ndikim potencial mbizotërues, u zbeh gradualisht.

5. Komentuesit dhe e drejta e Justinianit

Që nga fundi i shekullit të trembëdhjetë e këndej, ndodhi një kalim i rëndësishëm i vëmendjes në studimin e së drejtës Romake. Sistemi ligjor i kohës, i cili në pjesën më të madhe të tij ishte një përzierje e zakonit feudal dhe e mbetjeve të kodeve të së drejtës popullore të Viteve të Errëta, u ndikua në mënyrë të pashmangshme nga ringjallja akademike e së drejtës romake në universitete. Ky proces u zhvillua nga fakti që disa studiues, të cilët u grumbulluan nga e gjithë Evropa në Bolonjë dhe shkolla të tjera juridike, kishin poste të larta në vendet e tyre. Shkollarët e periudhës së vonë mesjetare, të njohur si Komentuesit, synonin kryesisht të përshtatnin të drejtën për përdorim bashkëkohor. Në kundërshtim nga Glosatorët, ata nuk ishin të interesuar të interpretonin tekstet ligjore Romake të izoluar, por u përpoqën të ndërtonin një sistem ligjor të përshtatshëm për nevojat e Italisë së shekullit të katërbëdhjetë, duke përshtatur tekstet për rrethanat e kohës së tyre dhe duke nxjerrë parime ligjore nga këto tekste. Kodifikimi i Justinianit, jo vetëm që arriti një status të nderuar nëpërmjet punës së doktorëve të Bolonjës, por filloi të konsiderohej, sidomos vepra Digest si një arkiv zgjidhjesh, praktikisht për të gjitha problemet ligjore. Konfliktet, mospërputhshmëritë dhe opinionet e ndryshme që gjendeshin në veprën Digest, pavarësisht për pjekjeve të mëdha të Justinianit, ofronin një rezervë të pasur mundësish, Komentuesit ishin të aftë të transformonin të drejtën e Justinianit në ius commune, një e drejtë zakonore e përbashkët për të gjithë

Evropën, si dhe të aplikonin në llojet e pasura të së drejtës joromake në Evropë mënyrat e tyre të të menduarit për të drejtën.¹⁰

Puna e tyre u ndikua qartë nga Ultramontanët. Komentuesit, të cilët fillimisht ishin juristë Italianë të shekullit të katërbëdhjetë, ndikuan veçanërisht nëpërmjet mësimdhënies dhe veprave të tyre. Metodat e mësimdhënies ishin të ngjashme me ato të Glosatorëve. Bologna pushoi së qeni shkolla më e shquar, disa universitete të tjera Italianë u lidhën ngushtë me Komentuesit, përfshirë Padovën, Peruxhian, dhe Napolin. Veprat e tyre letrare kishin dy forma kryesore, komente të hollësishme ose monografi mbi kodifikimin e Justinianit, siç ishte shpjeguar nga Glosatorët, si dhe përmbledhje opinionesh mbi probleme ligjore specifike. Në të dy llojet e veprave, shkrytarët patën parasysh statutet vendore dhe zakonet. Për rrjedhojë, ata ishin të përgatitur për të interpretuar tekstet romake shumë më brishtë sesa Glosatorët, duke i bërë ato më të përshtatshme për kohën e tyre.¹¹

Bartolus shkroi komentin më të rëndësishëm të periudhës, një vepër e cila u bë teksti standard për vitet pasuese dhe nga e cila lindi shprehja askush nuk është jurist nëse nuk është Bartonist.¹² Detyra e përshtatjes së të drejtës romake për përdorim praktik në sisteme, të cilat bazoheshin pjesërisht në ligjin zakonor, e bëri Bartolus-in të parashikonte problemet që mund të lindnin nga konflikti i të drejtave në zona të ndryshme të Evropës. Një problem rrënjësor ishte konflikti i mundshëm midis së drejtës vendore dhe Corpus Iuris Civilis. Bartolus e hodhi poshtë nocionin që ky i dyti duhet të mbizotërojë automatikisht. Ai mbronte mendimin se problemi në thelb qëndronte tek interpretimi i qëllimit të së drejtës vendore. Komentuesit më të shquar ishin Bartolus de Saxoferrato dhe nxënësi i tij Baldus-i de Ubaldis-i 1327-1400.

Në këtë kuadër, ai mund të shihet me të drejtë si babai i konfliktit të të drejtave, sepse e bëri këtë një disiplinë ligjore specifike. Baldus, një studiues me interesa të gjëra, ishte përgjegjës për përmbledhjen më të pasur të opinionëve të epokës së tij. Vepra e tij dhe e Bartolus-it frymëzoi brezat pasardhës të studiuesve, aq sa në mesin e shekullit të pesëmbëdhjetë Komentuesit ishin aktivë në qendrat akademike të pjesës më të madhe të Evropës.¹³ Rezultati ishte zhvillimi i traditës të

¹⁰ Johnston, D., "The Renewal of the old" (1997) Cambridge LJ, 80-95.

¹¹ Referohu, Sellers, M. N. S. , Republikанизmi Amerikan (1994).

¹² Wieacker, History, 57. 1178 Wieacker, History, 60.

¹³ Wieacker, History, 57. 1178 Wieacker, History, 60. Kjo literaturë ishte katalizatori kryesor për Pranimin e së drejtës romake në Gjermani pas shekullit të pesëmbëdhjetë,

së drejtës evropiane, një gjuhë e përbashkët kjo, bërthama e së cilës ishte e drejta romake, ashtu sikurse dhe disa nga gjuhët e Evropës kishin rrënjë të përbashkëta nga Latinishtja.

Ndikimi i këtyre italianëve është një nga shembujt më të rëndësishëm në historinë e shkëmbimit të vazhdueshëm midis popujve të Evropës. Gjithashtu, epërsia e së drejtës romake, në krahasim me trillet e së drejtës feudale, që përshkonin një pjesë të madhe të Evropës në periudhën mesjetare, u nxit nga avokatët akademikë profesionistë. Diskutimet publike mbi meritat e së drejtës romake ishin të zakonshme, veçanërisht në universitetet e Gjermanisë dhe mësimdhënia e së drejtës romake ne pjesën më të madhe të universiteteve të Evropës, ishte një nga arritjet më të mëdha të periudhës.¹⁴

6. Transformimi i së drejtës romake në ius commune

Nga fundi i shekullit të katërmbëdhjetë, e drejta romake ishte transformuar në ius commune të Evropës e drejta komunitare evropiane. Ky proces kishte ndodhur në tri faza. Gjatë shekullit të dymbëdhjetë, kodifikimi i Justinianit ishte krahasuar me përpikëri nga Glosatorët dhe i kishte dhënë një pjesë shumë të madhe të fjalorit dhe doktrinës së së drejtës kanonike që po lindte. Gjatë shekullit të trembëdhjetë, interpretimi liberal i Shkollës së Orlearlit i kishte dhënë një version të ri interpretimit të këtyre teksteve, ndërsa *Komentuesit* e shekullit të katërmbëdhjetë kishin përzier të drejtën romake bashkë me zakonet dhe statutin vendor, në një sistem ligjor të përshtatur për nevojat e tyre specifike. Nëpërmjet përpjekjeve të këtyre juristëve, filloi një romanizim i së drejtës, i cili nuk ishte i ndryshëm nga transformimi që kishte ndodhur në jetën e territoreve të banuara nga romakët në kulmin e lulëzimit të Perandorisë Romake.

7. Procesi i transformimit romak dhe ideja e shtetësisë

Ky proces, i cili vazhdoi deri në fillimin e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, nuk solli vazhdimisht ndryshim të rëndësishëm në përmbajtjen e ligjit, transformimi shpesh ishte më i dukshëm në strukturën dhe procedurën e sistemeve ligjore dhe në metodat e teknikat e të

sepse, sa herë që vendimmarrja e kultivuar zëvendësohte gjykimin e pasofistikuar, përdorej kjo literaturë.

¹⁴ Wieacker, History, 61. Referohu, Robinson, et al., ELH, ss. 4.4.1-4.6.8; Stein, Roman Law, 71-4;-Bellomo, Common Legal Past, 147.

menduarit, të adoptuara nga avokatët akademikë dhe profesionistë. Romanizimi i së drejtës u detyrohej shumë faktorëve politikë dhe ekonomikë. Zhvillimi i idesë së shtetësisë, karakteristikë e shekujve pesëmbëdhjete dhe gjashtëmbëdhjete, e bëri të drejtën romake tërheqëse për disa prej sunduesve të shteteve evropiane në zhvillim, duke qenë se konsiderohej me karakter imperialist, autoritar, të centralizuar dhe jofetar. Për më tepër, kasta tregtare në zhvillim, në shtetet evropiane, shpesh gjente për të drejtën romake, veçanërisht në ligjin e saj mbi kontratat, një bazë të sigurt ligjore për përpjekjen tregtare në krahasim me ligjet zakonore të vjetruara e të copëtuara që mbizotëronin atëherë. Vetëm fakti që e drejta romake ishte ligj i shkruar, me burime lehtësisht të identifikueshme, i dha asaj siguri dhe autoritet e, për rrjedhojë, edhe një avantazh të madh në krahasim me zakonin e pashkruar. Romanizimi i së drejtës në Itali u ndikua nga një faktor i pazakontë përdorimi i kushtetutës podesta.¹⁵

Qytetet italiane në periudhën mesjetare ndonjëherë bëheshin të paqeverisshme, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve midis grupeve dhe familjeve kundërshtarë. Prandaj, si ekspedient, ose si një lloj zgjidhje u arrit që, herë pas here të ftohej një i huaj i paanshëm që quhej podestd për të vepruar me kompetencën juridike dhe administrative si guvernator për të rivendosur rendin. Ai mund të zbulonte se problemi qëndronte pjesërisht në përdorimin e së drejtës vendore. Në këtë rast, mund të ishte e arsyeshme të gjendej zgjidhja te një ligj natyror domethënë tek e drejta romake, për të gjykuar çështje të vështira. Podesta normalisht trajnohej në të drejtën romake në fakt, disa Glosatorë dhe Komentues njihet se e pranonin ftesën.

8. Retrospektivë historike në ringjalljen e së drejtës romake

Me anë të një retrospektive, historike, natyrisht, konstatojmë se faktorët e shumtë që kontribuuan në ringjalljen e së drejtës romake në periudhën mesjetare, mund të thuhet se sollën pranimin e saj në një mënyrë të pashmangshme. Në këtë kuadër, është e çuditshme ajo që lexojmë tek Vinogradoff, në të gjithë hapësirën historike nuk ka problem me të rëndësishëm dhe të çuditshëm sesa ai që lidhet me fatin e së drejtës romake pas rënies së Shtetit Romak. Si është e mundur që një sistem i krijuar për të përmbushur nevojat në disa rrethana historike,

¹⁵ Roman Law in Medieval Europe (1929), f. 11. The Evolution of Law (1985) 97, dhe përgjithësisht kapitulli III-të.

jo vetëm që u mbijetoi këtyre rrethanave, por ruajti gjallërinë e tij deri në ditët e sotme kur mjediset politike dh e shoqërore janë krejt ndryshe. Nga ana tjetër, Watson mbron idenë se huazimet e mëdha të vullnetshme nga e drejta romake, mund të priteshin nga shoqëri të cilat kishin një sistem kryesisht zakonor, edhe pse në to mbizotëronin rrethana të ndryshme politike, shoqërore, ekonomike ose fetare. Prandaj, mospranimi i saj do të ishte përbërë problemin më të çuditshëm të historisë. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm për të kuptuar pranimin, është të dimë si duhet të shpjegojmë kauzën e tij, duke iu shmangur kauzave të tij.¹⁶ Nacioni se kërkimi për kauza është keqkuptuar disi nëse kjo është ajo çka argumenton Watson, është vështirë për t'u pohuar, megjithëse teza se huazimi ligjor mes shoqërive është i mundshëm ose i pashmangshëm, është më se e kuptueshme.¹⁷ Siç thotë Wieackef: Adoptimi nga ana e një populli i elementeve kulturore të formuara nga një popull tjetër, është thjesht një shembull midis shumë prej ndryshimeve të vazhdueshme nga të cilat varen të gjitha qytetërimet njerëzore. Vetë ideja e pranimit tregon qartë sensin tonë të vazhdimësisë së historisë njerëzore në tërësi, ose, në çdo rast, vazhdimësinë e qytetërimeve të mëdha.

9. Romanizimi i ligjit mori forma të pangjashme dhe eci me ritme jo të njëlojta në vende të ndryshme

Përgjithësimet janë të pasakta, veçanërisht kur bëhen në lidhje me pranimin, por mund të pranohet pa frikë se askund nuk pati metamorfozë të papritur e të menjëhershme nga e drejta feudale për tek e drejta romake. Megjithatë, ndodhën disa ngjarje si reforma e gjykatave ekzistuese ose funksionimi i gjykatave të reja të apelit që përdornin të drejtën e mësuar, të cilat pa dyshim e përshpejtuan përparimin e pranimit. Sunduesit synonin të punësonin në gjykatat e tyre të larta juristë të trajnuar në të drejtën romake. Kjo solli një vartësi të konsiderueshme ndaj avokatëve të aftë, të cilët ishin të trajnuar për të drejtën romake në universitete.

Bashkëpunimi ndërshtetëror për një të drejtë të përbashkët Punësimi në gjykata apeli i gjykatësve të trajnuar për të drejtën romake, rezultoi faktor i rëndësishëm për pranimin në disa shtete, përveç Gjermanisë, dhe sidomos Vendeve të Ulëta dhe Skocisë. Në vendet e

¹⁶ Roman Law in Medieval Europe (1929), f.11.

¹⁷ Fuero Juzgo "zakoni i gjykatësve", e drejta Vizigote që zbatohet në gjykatat e apelit. Ringjallja e së drejtës 1183 History, 91.

Mesdheut Perëndimor, Spanjë, Francë dhe Itali pranimi në përgjithësi mori një rrjedhë më të ngadaltë dhe graduale. Në këto vende kishte mungesë të ngjarjeve të rëndësishme në fazat e mëvonshme të pranimit, kryesisht për shkak ose drejta romake kishte hedhur rrënjë në këto zona gjatë Viteve të Errëta. Në Spanjë, për shembull, e drejta romake ishte e pranishme në të drejtën Vizigote dhe u mbijetoi dyndjeve mauritane. Në shekullin e trembëdhjetë, një varg mbretërisht romake në Spanjë u ndihmua veçanërisht nga personat që ishin në shërbim mbretëror dhe që kishin studiuar në Itali ose në Universitetin e Salamankës.¹⁸

Në rajonin e Alfonsit X (1252-84) ekzistonte një paraqitje e qartë, e shpallur e së drejtës, Las Siete Partidas, Shtatë Pjesët e së Drejtës, e bazuar mbi të drejtën romake, ajo arriti gradualisht një njohje të përgjithshme gjatë periudhës së ripushtimit të qyteteve spanjolle nga mauritanët dhe filloi të konsiderohej si themel i së drejtës spanjolle, rrjedhimisht edhe e drejta e Botës së Re, Amerika Jugore, kur Spanja filloi të shtrinte perandorinë e saj të gjerë përtej detit. Vështirë të gjendet një vend në Evropë që nuk u ndikua nga pranimi i së drejtës romake, edhe pse në disa zona sidomos në Skandinavi dhe në pjesë të Evropës Lindore, si Polonia, ndikimi ishte më i vogël, të paktën deri në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, pavarësisht nga mësimdhënia e së drejtës kanonike dhe e një pjese të së drejtës romake në universitete.¹⁹

Conclusion

From this perspective, for the rights and the role of the Ottoman Empire in the Albanian territories, this story remains in possession of the central archives of Istanbul, remains to be explored by Albanian scholars, jurists and historians and for these researches to seek help from today's Turkish friends. Only in this scientific standpoint will be identified with Slavic periods, a bitter and horrible history for the Albanian people, or let's call it, "The nineteenth century has been horrible for Albanians", the Slavs led by the Serbo-Montenegrins and others so much have caused damages, that even today the consequences

¹⁸ Fuero Juzgo "zakoni i gjykatësve", e drejta Vizigote që zbatohet në gjykatat e apelit. Ringjallja e së drejtës 1183 History, 91.

¹⁹ Siç thotë Wieackef: "Adoptimi nga ana e një populli i elementeve kulturore të formuara nga një popull tjetër, është thjesht një shembull midis shumë prej ndryshimeve të vazhdueshme nga të cilat varen të gjitha qytetërimet njerëzore. Vetë ideja e pranimit tregon qartë sensin tonë të vazhdimësisë së historisë njerëzore në tërësi, ose, në çdo rast, vazhdimësinë e qytetërimeve të mëdha.

are very serious in all vital activities of the Albanians. Slavic primary specialties were theft, plunder, occupation and extermination of every letter of the Albanian language, so these daunting times for Albanians and Albanian jurists will be a priority of the study of Slavic methods and strategies to reach the truth and witness or factualization of Slavic guilt towards the Albanian people, remain to be researched.

Seeing at this prism, we can conclude that Albanian right needs a more detailed study approach both by research character and by the factualization of historical data and its unification for international comparison with the rights of other nations to take the position of Albanians in scientific terms and that of their acceptance in the legal equality of global science within the great nations and all over the world.

LITERATURA

- ✚ Arta Mandro „E drejta romake” Tiranë , 2011.
- ✚ Bashkim Dr. Selmani „E drejta Romake dhe ndikimi saj në të drejtën bashkëkohore „Universiteti Tetovës, Tetovë, 2013
- ✚ Bonfantes Pietro, “Storia del Diritto Romano” (Vol I-II), Societa Editrice Libreria, Milano 1923.
- ✚ Enkeleda Olldashi “E drejta romake” Botimi i pare, Media print Sh. p. k.
- ✚ Puhan Ivo, “E drejta romake” Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore KSAK-Prishtinë 1980.
- ✚ Bashkim Selmani „E drejta e regjistrimit të patundshmërisë” Tetovë, 2011
- ✚ Paul Koschaker: Europa und das römische Recht.
- ✚ Auflage. Beck, München 1966,
- ✚ Legier Gerard “E drejta civile DETYRIMET Botimi 19-të Papyrus, Tiranë, 2009
- ✚ Mirjana Polenak –Aqimovska & Vlado Buçkovski “Zgjedhje e teksteve nga e drejta romake” Kumanovë, 2003 “Makedonska riznica” -Kumanovë
- ✚ Paolo Biavati & Michele Angelo & Redi Nazim Shtino “E drejta procesuale Europiane” GER, Tiranë, 2010
- ✚ Bashkim Dr. Selmani & Bekim Rexhepi „E drejta Romake ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore Ferizaj, 2014.
- ✚ Kadriu Osman “Hyrje në të drejtën civile” - Shkup 2008.

- ✚ Franz Wieacker: Privatrechtsgeschichte der Neuzeit unter besonderer Berücksichtigung der deutschen Entwicklung. 2. Auflage. Vandenhoeck u. Ruprecht, Göttingen 1967,
- ✚ Statovci Ejup “Origjina dhe zhvillimi studim komparativ” Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i KSAK-së Prishtinë, 1983.
- ✚ Nuni Ardian “E drejta civile pjesa e përgjithshme” Tiranë, 2009.
- ✚ Mandro Arta E drejta familjare, familja, fëmijët, martesë, bashkëshortë Emal Tiranë 2009.
- ✚ Meçani Delo “Pronësia mbi tokën” alb Paper Tiranë.
- ✚ Podvorica Hamdi “E drejta trashëgimore” Prishtinë 2006
- ✚ Omari Onila “E drejta familjare” Tiranë, 2008
- ✚ Berberi Sokol “Parime dhe rregulla për hartimin e Akteve Normative” Teknika legjislativë QSP/CPS- Tiranë 2006.
- ✚ Gjata Rustem “E drejta civile sendet dhe pronësia” alb PAPER, Tiranë, 2011
- ✚ Brestovci Fail “E drejta procedural civile II Prishtinë, 2006.
- ✚ Podvorica Hamdi “E drejta trashëgimore”, Prishtinë 2008.